



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT ME TAKSI TË UDHËTARËVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2023

KUSHTET PËR APLIKIM

A) Transporti taksi i udhëtarëve-personat fizik:

- të ketë vendbanim në territorin e komunës së Podujevës
- të jetë pronar i automjetit me të cilin ushtron këtë veprimtari,
- të ketë fotokopjen e policës së sigurimit
- të ketë lejen e drejtuesit të kategorisë „B”
- të ketë së paku 5 (pesë) vite patentë shofer
- të ketë biznesin e regjistruar
- të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë për TAKSI drejtues
- të ketë dëshmi mbi kryerjen e obligimeve mbi taksën komunale
- të ketë certifikatën mjekësore
- të ketë njohuri për qytetin
- leja e punës për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse për vitin 2022

Automjeti, përveç kushteve tjera të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojë edhe këto kushte:

- të ketë së paku katër (4) dyer
- të ketë më së shumti 4+1 ulëse
- të ketë taksimetrin
- të ketë të vendosur mbi automjet shenjën “TAXI” ose „RADIO-TAXI”, e cila duhet të ndriçojë natën
- automjeti duhet të jetë jo më i vjetër se viti 2000

Vërejtje: numri i auto-taksive është i kufizuar në 10 dhe përzgjedhja do të bëhet sipas kriterëve

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse, të adresuara për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

<https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2023/03/Aplikacioni-per-taksi.docx>

B) Transporti taksi i udhëtarëve –ndërmarrja

- të ketë licencë për këtë lloj transporti
- të ketë selinë në territorin e komunës së Podujevës
- të ketë certifikatën e regjistrimit të biznesit
- të ketë së paku 3 automjete në pronësi,të cilët duhet të jenë me ngjyrë të njëjtë
- të ketë së paku 3 (tre) shofer të punësuar,të cilët posedojnë lejen e drejtuesit të automjetit,të kategorisë,,B”, më të vjetër se 5 vite
- të ketë leje qarkullimi për të gjitha automjetet në pronësi, të cilat duhet të jene të një lloji, me ngjyre te njejte ,
- Automjetet të jenë të paisura me taximetra
- të ketë vendqëndrim dhe sistemin e radiolidhjeve
- të ketë librezën e qarkullimit
- fotokopjen e policës së sigurimit
- certifikatat mjekësore për shoferët
- të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë për “TAXI”ose,,RADIO-TAXI” drejtues
- të ketë dëshmi mbi kryerjen e obligimeve mbi taksën komunale.
- leja e punës për ushtrimin e veprimtarisë përkatse për vitin 2022

Aplikacionet mirren dhe dorëzohen në Zyrën Pritëse,të adresuar për Drejtorinë e Shërbimeve Publike,Mbrojtje dhe Shpëtim.

C) Kompanitë e licencuara “radio taxi” dhe me leje veprimi brenda territorit të komunës së Podujevës,në kushte të njehta mund të aplikojnë për shtim të Automjeteve deri në 5 (pesë) automjete

Vërejtje: numri i automjeteve duhet të jetë i barabartë me numrin e shoferëve të punësuar

